Në pajtim me Nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës , Nenit 4 Paragrafi 3 dhe Nenit 6 Paragrafi 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 Për Rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik , Nenit 11.3 të Rregullores për Themelimin e Marrëdhënies së Punës , Vendimit Nr.14/2024 të datës 01.03.2024 , Punëdhënësi NPL "Stacioni Autobusëve Gjilan" Sh.A më datë **01.03.2024** *rishpall :*

KONKURS PUBLIK

NPL STACIONI AUTOBUSËVE
Nr. 115 Dt. 01.03.2024
GJILAN

Për plotësimin e vendeve të lira të punës :
NPL "Stacioni Autobusëve Gjilan" Sh.A

Pozita I :
Titulli i Pozitës : ***Punëtor/e i/e Laurës***
Numri i Pozitave : ***2 (dy) vende pune***
Numri i Referencës : ***14/01-03-2024***
Koeficienti i pagës : ***Katërqind e nëntëmbëdhjetë Euro (419.00 €)***
Kohëzgjatja e Kontratës: ***Në kohë të pa caktuar***
Orari i plotë : ***Dyzet orë (40) në javë***

Detyrat dhe Përgjegjësitë :
- *Ngrit dhe ulë laurën gjatë hyrjes dhe daljes së operatorëve në stacionin e autobusëve*
- *Laurën dalëse nuk guxon t'a hap për t'i shërbyer dikujt si hyrje përveq KFOR-it , Policisë , Ndihmës së shpejt dhe zjarrfikësve kur janë në kryerje urgjente të detyrës,gjithashtu në laurën hyrëse punëtori ka të ndaluar të ngritë laurën e cila do të shërbente si dalje përveq atyre që i cek te laura dalëse*
- *Bënë arkëtimin e tarifave për hyrje – dalje të autobusëve dhe automjeteve të tjera në stacion*
- *Ngarkohet me bllok të biletave të llojeve të ndryshme - nevojshme*
- *Kujdeset për mirëvajtjen , mirëmban dhe pastron objektin ku është instaluar shërbimi i laurës*
- *Mban librin e evidencës së rendit të udhëtimit për secilin operator të vertetuar nga Ministria e Infrastrukturës e cila evidenc duhet t'i dorëzohet në fund të muajit në kopje Inspeksionit regjional të MI-ës*
- *Lëshon në parking (hyrje) vetëm ata që paraprakisht kryejn pagesën për hyrje*
- *Ngarkohet dhe jep bileta për të gjithë transportuesit dhe bënë rezervimin e tyre në mënyrë precize në bazë të dëshmisë së shitjes së biletave për secilin transportues që shfrytëzon shërbimet e stacionit brenda shërbimit të shitjes së biletave.*
- *Gjatë procesit të shitjes së biletave duhet të jetë korrekt dhe nuk guxon t'i jep perparësi asnjë kompanie të transportit , por në mënyrë të barabart sipas rendit të udhëtimit*
- *Kryen edhe punë të tjera sipas urdhërit të eprorit*

Kushtet për punësim :
-Të ketë të kryer së paku shkollën e mesme
-Përvoja e punës në sigurim apo të ngjashme (e preferuar)
-Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës
-Të ketë aftësi komunikuese me operatorët privat të transportit

Kandidatët (aplikantët) për pozitën e lartëpërmendur duhet të kompletojnë dhe të dorëzojnë dokumentacionin e domosdoshëm (kopje) si në vijim :

1.Aplikacioni i punësimit
2.Dëshmi të kualifikimit shkollor (diplomën të noterizuar)
3.Dëshmi mbi përvojën e punës një (1) vjeqare (të dëshmuar me trust pensional)
4.Kopjen e Dokumentit të Identifikimit
5.Certifikatën e lëshuar nga gjykata me të cilën dëshmohet se kandidati nuk është nën hetime dhe nuk është i dënuar për ndonjë vepër penale.
6.Certifikatën mjekësore për punësim (pas përzgjedhjes)

Informatë për kandidatët :

-Për pozitën e lartëpërmendur zbatohet periudha provuese prej gjashtë (6) muajve në pajtim me nenin 15 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.

-Aplikacionet merren dhe dorëzohen në pliko të mbyllura në arkivin e NPL "Stacioni Autobusëve Gjilan" Sh.A brenda orarit zyrtar të punës nga ora 08:00 deri 15:00.

-Afati i aplikimit është pesëmbëdhjetë (15) ditë duke filluar nga data 04.03.2024-18.03.2024 në tabelën e shpalljeve të ndërmarrjes dhe në faqen zyrtare të Komunës së Gjilanit.

-Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të pranohen , ndërsa ato të mangëta do të refuzohen , ndërsa do të kontaktohen dhe ftohen për intervistë vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë.

Punëdhënësi :
NPL "Stacioni Autobusëve Gjilan" Sh.A

NPL "STACIONI AUTOBUSËVE GJILAN" Sh.A.